



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

NJOFTIM

Në mbledhjen e datës 19 mars 2026, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe diskutimeve të zhvilluara në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, mori vendimet që vijojnë:

U vendos fillimi i procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “HYDROSOLAR ENERGY (HSE)” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

U vendos fillimi i procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “SUNNY SIDE ENERGY” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

Bordi u informua mbi kërkesën e bërë nga persona të tretë për pezullimin e licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “VOKOPOLA ENERGJI” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 161, datë 17.06.2022.

U miratua kërkesa e shoqërisë “SA-GLE KOMPANI” sh.p.k. për marrjen e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të saj si mjet për garantimin e detyrimit ndaj “First Investment Bank-Albania” sh.a.

U miratua kërkesa e shoqërisë “ENER TRADE” sh.p.k. për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës.

Në çështje të tjera, Bordi u informua mbi raportin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale mbi indeksin e transparencës proaktive të autoriteteve publike për vitin 2025, si dhe për njoftimin në lidhje me ndryshimet në anëtarësinë e bordit drejtues/këshillit mbikëqyrës të TAP AG, për muajin shkurt 2026.

Vendimet e plota publikohen në faqen zyrtare të ERE-s dhe në Fletoren Zyrtare.